

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XIX, nr. 5960  
E shtunë, 21 dhjetor 2019  
çmimi 0.40 €

## Rusia është kërcënimi real dhe global i Kosovës (3)

Dr. Enver HOXHAJ

IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:


[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI I FAQE 4-5

# MARRËVESHJA DO TË KETË SHIJE TË HIDHËT PËR PALËN QË I NËNSHTROHET SHANTAZHIT



Analisti politik Shkëlzen Maliqi beson se Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) mund të arrijnë një marrëveshje për bashkëqeverisje. Në këtë intervistë

dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se një marrëveshje e tillë do të ketë shije të hidhët për palën që do t'i nënshtrohet shantazhit. Sipas Maliqit, LV-ja dhe LDK-ja fazën finale të nego-

ciatave për ndarjen e posteve e kanë kthyer në pazar dhe kushtëzime joprincipiale. Ai ka thënë se nëse nuk ka marrëveshje mes këtyre dy partive, alternativë reale janë zgjedhjet e reja

## EDHE GJASHTË DITË SEANCA KONSTITUIVE E KUVENDIT, LV-ja DHE LDK-ja ENDE PA MARRËVESHJE

Më 26 dhjetor presidenti Hashim Thaçi ka thirrur mbledhjen e parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës, por Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende

nuk kanë arritur marrëveshje për bashkëqeverisje. Të premtën janë takuar sërish Albin Kurti dhe Isa Mustafa, por edhe ky takim nuk ka sjellë rezultat pozitiv për arritjen e një marrëveshje. Nënkrjetari i LV-

së, Besnik Bislimi, ka thënë se negociatat kanë ngecur për arsye se në tavolinë kanë dalë kërkesa pa mbulesë. Megjithatë, ai ka shprehur optimizëm se vendi do të bëhet shumë shpejt me institucione

### OPINION

NUK KA ASNJË ARSYE TË MOS BËHET KOALICIONI MIDIS LV-së DHE LDK-së F. 10

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



15 DITË NË SPITAL, MANDEJ NË BURGUN USHTARAK TË NISHIT F. 12

LULZIM SAHITI



### AKTUALE



VUÇIQI PRITET ME PROTESTA NË TIRANË NË SAMITIN E MINISHENGENIT BALLKANIK F. 2

LIGJVËNËSIT BRITANIKË MBËSHITESIN PLANIN E JOHNSONIT PËR BREXITIN F. 11

### EKONOMI

ZKA-ja: S'KA SIGURI SE USHQIMI NË TREG ËSHTË MJAFTUESHËM I KONTROLLUAR DHE I SIGURT F. 9

### KULTURË

LIBËR ME KOD PRITJEJE PËR KUJTESËN HISTORIKE F. 14

Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegijibiznesi.com](http://www.kolegijibiznesi.com)  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# SIGMA



## VIENNA INSURANCE GROUP

**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË**

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• **Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*  
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• **Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*  
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Interalbani Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• **Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)

## Paketa anti-shpifje nuk pasqyroi rekomandimet e Këshillit të Evropës

BRUKSEL, 20 DHJETOR - Ndryshimet e ligjeve të medias në Shqipëri, që u miratuan të mërkurën mes polemikave e kritikave të shumta, vazhdojnë të ngjallin shqetësim. Një zëdhënës i Komisionit Evropian tha se Brukseli "merr shënim" miratimin në parla-

ment të paketës anti-shpifje. Megjithëse ligjit iu bënë ndryshime deri në minutën e fundit dhe qeveria Rama theksoi se ato janë bërë në përputhje të plotë me OSBE-në, zëdhënësi i Komisionit, tha se "rekomandimet e ekspertëve të

Këshillit të Evropës nuk janë marrë në konsideratë" në variantin përfundimtar.

Zëdhënësi tha se Brukseli do të vazhdojë të punojë nga afër me autoritetet shqiptare, për t'u siguruar që standardet evropiane për lirinë e të shprehurit dhe

mediet do të respektohen.

Përfaqësues të medieve shqiptare si dhe të institucioneve ndërkombëtare kanë qenë të një mendjeje se amendamentet e reja paraqesin problem lidhur me garantimin e lirisë së medieve.



## Vuçiçi pritet me protesta në Tiranë në Samitin e minishengenit ballkanik

Përderisa kryeministri shqiptar Edi Rama i ka pritur në përfaqim presidentin serb Aleksandar Vuçiçi dhe kryeministrin maqedonas Zoran Zaev për të marrë pjesë në samitin e minishengenit ballkanik, i cili është bojkotuar nga Republika e Kosovës, një grup i përfaqësuesve të Vetëvendosjes kanë kundërshtuar vizitën e presidentit serb

TIRANË, 20 DHJETOR - Aktivistë të degës së Vetëvendosjes në Tiranë janë përplasur me policinë para hotelit ku ndodhet presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiçi. Presidenti serb ka mbërritur të premten rreth orës 17:00 në Tiranë dhe ndodhet në një prej hoteleve kryesore të qytetit, për të marrë pjesë në takimin e minishengenit ballkanik.

Një grup i përfaqësuesve të Vetëvendosjes kanë kundërshtuar vizitën e tij, duke argumentuar se një njeri që nuk dënon krimet ndaj shqiptarëve në Kosovë nuk

mund të vij në Shqipëri.

Raportohet se ka pasur përplasje me aktivistëve dhe forcave të shumta të policisë që sigurojnë delegacionin e presidentit serb. Sipas policisë, aktivistëve u është dhënë leje për të protestuar vetëm në një perimetër të caktuar dhe jo në zonat ku dëshirojnë ata.

Drejtuës të Vetëvendosjes në Tiranë thanë për mediet se Vuçiçi nuk është mirëpritur në Shqipëri.

"Unë po mbroj dinjitetin e shqiptarëve. A mori leje Vuçiçi kur erdhi në Shqipëri? A jemi shqiptarë në Shqipëri apo e kemi me qira këtë tokë", tha një protestues.

"Ai është kriminel, ka vrarë shqiptarë", dëgjoheshin thirrjet e disa nga protestuesve. Të premten dhe të shtunën, presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiçi dhe kryemi-



nistri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev do të qëndrojnë në Tiranë për të qenë të pranishëm dhe zhvilluar atë që njihet si takimi i "mini-shengenit ballkanik". Pas takimeve të zhvilluara në Novi Sad të Serbisë dhe Ohër të Maqedonisë së Veriut, kësaj here treshja Rama, Vuçiçi dhe Zaev po takohet në Tiranë.

Mohimi i masakrës së Reçakut nga shteti i Serbisë ka bërë që në mesin e shumë arsyeve të tjera,

partitë politike në Kosovë të kërkojnë nga Shqipëria një qasje tjetër ndaj Serbisë. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi pasi i tha "jo" ftesës së Ramës, deklaroi se derisa Serbia vazhdon t'i mohojë krimet e kryera ndaj qytetarëve të Kosovës dhe nuk e njeh Kosovën si shtet, iniciativat për bashkëpunim rajonal janë krejtësisht të pakuptimta.

"Mbështetja dhe bashkëpunimi reciprok ndërmjet Kosovës dhe

Shqipërisë është i natyrshëm dhe i përhershëm. Mirëpo, për dallim nga Republika e Shqipërisë, Republika e Kosovës vazhdon edhe më tutje të ketë pengesa serioze në konsolidimin e shtetësisë së vet. Fatkeqësisht, pengesa kryesore vjen nga Serbia, e cila në të gjitha format dhe mundësitë, në mënyrë të vazhdueshme minon përpjekjet tona për konsolidimin e shtetësisë sonë", shkroi në rrjetet sociale presidenti Thaçi.



## Yuri Kim, ambasadorja e re e ShBA-së në Shqipëri

TIRANË, 20 DHJETOR - Senati amerikan, në takimin e fundit për këtë vit, ka konfirmuar diplomaten Yuri Kim si ambasadore të Shteteve të Bashkuara në Republikën e Shqipërisë. Ajo u emërua nga presidenti Donald Trump në qershor të këtij viti.

Yuri Kim ka marrë përfundimisht dritën jeshile të Senatit amerikan për të shërbyer si ambasadore e ShBA-së në Shqipëri duke u zyrtarizuar në këtë detyrë.

Ambasadorja Yuri Kim, në një

seancë para Komisionit të Jashtëm të Senatit për konfirmimin e saj në fund të teoritit, tha se do t'i nixiste udhëheqësit e vendit për bashkëpunim në mënyrë që të forcohet perspektiva e hapjes së negociatave të anëtarësimit në BE.

Po ashtu, ambasadorja e ShBA-së, Kim ka theksuar se do të inkurajonte gjithashtu Shqipërinë të zbatonte plotësisht reformën në drejtësi, përfshirë kontrollin e figurës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe krijimin e strukturave të posaçme

për luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Kim tha se sheh si përparësi edhe ndihmën teknike për Shqipërinë në hetimin, ndjekjen dhe ndëshkimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar ndërnacional.

Gjithashtu, premtoi se do të punonte për të nxitur eksportet dhe investimet amerikane në Shqipëri.

Yuri Kim është anëtare në stafin e lartë të Shërbimit të Huaj dhe ka shërbyer në Departamentin e Shtetit si drejtore e Zyrës së

Çështjeve të Evropës Jugore. Më herët, ajo ka qenë drejtore e Qendrës së Departamentit të Shtetit për Studimin e Diplomacisë, shefe e stafit për zëvendëssekretarin e Shtetit dhe drejtore e Zyrës për Sigurinë Evropiane dhe Çështjeve Politiko-Ushtarake. Ka qenë gjithashtu asistente speciale e ndihmës Sekretarit të Shtetit për Çështjet e Azisë Lindore dhe Paqësorit dhe anëtare e delegacionit të Shteteve të Bashkuara në bisedimet gjashtëpalëshe për t'i dhënë fund programit



bërthamor të Koresë së Veriut. Kim ka shërbyer si këshilltare politike në Ambasadën e ShBA-së në Bagdad dhe në Ankara. Ajo ka lindur në Kore dhe është rritur në ishullin Guam, një territor i ShBA-së në Oqeanin Paqësor, ndërsa në Shqipëri do të pasojë Donald Lu.

Ajo flet gjuhën koreane, kineze (mandarinisht), japonisht dhe turqisht.

# Edhe gjashtë ditë seanca konstituive e Kuvendit, LV-ja dhe LDK-ja ende pa marrëveshje



Më 26 dhjetor presidenti Hashim Thaçi ka thirrur mbledhjen e parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës, por Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ende nuk kanë arritur marrëveshje për bashkëqeverisje. Të premtën janë takuar sërish Albin Kurti dhe Isa Mustafa, por edhe ky takim nuk ka sjellë rezultat pozitiv për arritjen e një marrëveshje. Nënkryetari i LV-së, Besnik Bislimi, ka thënë se negociatat kanë ngecur për arsye se në tavolinë kanë dalë kërkesa pa mbulesë, por ai është optimist se vendi do të bëhet shumë shpejt me institucione

**EPOKA E RE****Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Të premtën ka përfunduar edhe një takim pa marrëveshje ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK). Të dy liderët, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, kanë zhvilluar takimin e radhës brenda objektit të Kuvendit të Kosovës, i cili ka zgjatur rreth një orë.

Ishte Isa Mustafa që u pa i pari teksa doli nga ky takim i radhës, por që iu shmang medieve. Mustafa ishte i shoqëruar edhe nga nënkryetarët e LDK-së, Agim Veliu dhe Vjosa Osmani dhe deputeti Besian Mustafa.

Policia e Kuvendit nuk i lejoi mediat të afrohen afër liderit të LDK-së për të marrë deklaratë.

Edhe Albin Kurti iu shmang ballafaqimit me media, duke shfrytëzuar daljen prapa Kuvendit për t'u larguar pa u vërejtur.

Një ditë para këtij takimi ndërkombëtarët kanë shtuar presionin për formimin e institucioneve të Kosovës.

Ambasada e ShBA-së dhe e Britanisë së Madhe, si dhe Zyra e BE-së në Prishtinë, kanë vlerësuar se nevojitet formim i shpejtë i qeverisë së re për t'i çuar përpara proceset që e presin Kosovën.

Të njëjtën gjë kanë kërkuar edhe deputetët gjermanë Peter Beyer dhe Christian Schmidt, të cilët e kanë vizituar Kosovën dhe kanë takuar liderët e Lëvizjes

Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

Të enjten deputetët gjermanë në adresimin e tyre për media në Prishtinë kanë përmendur edhe çështjen e postit të presidentit të cilin po e kërkon LDK-ja dhe që është bërë pengesa kryesore për arritjen e marrëveshjes për koalicion qeverisës në mes të këtyre dy subjekteve.

Deputeti i CSU-së, Christian Schmidt, ka deklaruar se tani nuk është koha që të diskutohet për këtë çështje. "Tash për tash nuk është koha që të zgjidhet presidenti, por të formohet qeveria", ka thënë Schmidt. Ndaj kësaj ka reaguar edhe deputeti tjetër Peter Beyer, duke e aprovuar qëndrimin e kolegut me fjalën "saktësisht".

Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, pas takimit që ka pasur këtë javë me anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm të partisë, ka thënë se shpreson që para datës 26 dhjetor të arrihet marrëveshja me Lëvizjen Vetëvendosje. "Kisha dashur që koalicioni të lidhet para datës 26 dhjetor", ka thënë ai.

Ai ka thënë se posti i presidentit nuk duhet t'i bllokojë bisedimet për bashkëqeverisje me LV-në. Mustafa ka bërë me dije se i kanë ofruar LV-së një ministri më shumë për postin e presidentit, por që nuk e ka pranuar. "Ne kemi dhënë një propozim se si ta kapërcejmë këtë pengesë dhe nuk kam parë atë gatishmëri të LV-së dhe kemi propozuar që ne

të japim edhe një ministri për postin e presidentit, pra ne t'i kemi katër ministri e ata gjashtë", ka deklaruar Mustafa.

Lideri i LDK-së ka thënë se partia që drejton ka edhe plan "B" nëse nuk u jepet posti i presidentit. "LV

na ka pyetur se a kemi plan B. Ne i kemi thënë se plani është të shkojmë në opozitë", është shprehur Mustafa. Ai ka thënë se vonesat për moskrijimin e institucioneve janë përgjegjësi e partisë që ka dalë e para në zgjedhjet e 6 tetorit.

Besnik Bislimi, nënkryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, përmes një shkrimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka thënë se falë bashkëpunimit të mirë dypalësh LV-LDK është arritur pajtim pothuajse komplet në vizionin qeverisës dhe fokusin e reformave në drejtësi, ekonomi, arsim, shëndetësi, siguri, sport, kulturë e diasporë.

Bislimi ka shprehur optimizëm se vendi do të bëhet shumë shpejt me institucione. "U pasua pastaj

me takim në nivel liderësh për ta ndërmarrë hapin e fundit para konstituimit të institucioneve, atë të alokimit të përgjegjësive në qeverisje. Në një masë, edhe falë gatishmërisë maksimale për kompromis të Lëvizjes Vetëvendosje, edhe ky hap u kompletua me sukses sepse në asnjë mënyrë nuk duhej lejuar zbehja qoftë edhe minimale e shpresave të qytetarëve për ndryshime rrënjësore. Për momentin, duket se negociatat kanë ngecur, për arsye se në tavolinë kanë dalë kërkesa pa mbulesë, por jam shumë optimist që edhe kjo do të tejkalohet me maturi dhe vendi do të bëhet shumë shpejt me institucionet që i ka votuar dhe kërkuar", ka thënë Bislimi.



## Fillon shpërndarja e librave për nxënësit fitues të garave

SHTIME, 20 DHJETOR (ER) - Koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, Rexhep Hoti, ka filluar shpërndarjen e librave për fituesit e nivelit komunal të garës nacionale në Kreativitet Kulturor dhe

Mendim Kritik dhe garës nacionale të Diturisë. Të premtën u janë shpërndarë libra 150 nxënësve fitues të komunës së Shtimes, prej tyre 83 të KKKM dhe 43 të Diturisë, ndërsa 24 nxënës fitues të klasave të para dhe të dyta të

nivelit shkollor të garës së diturisë të cilët për shkak të moshës nuk e kanë vazhduar garën më tej. Hoti i ka përgëzuar nxënësit për suksesin dhe ka thënë se ata dëshmojnë se pa arsim të tjerat nuk kanë rëndësi.

Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

# Marrëveshja do të ketë shije të hidhët



Analisti politik Shkëlzen Maliqi beson se Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) mund të arrijnë një marrëveshje për bashkëqeverisje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se një marrëveshje e tillë do të ketë shije të hidhët për palën që do t'i nënshtrohet shantazhit. Sipas Maliqit, LV-ja dhe LDK-ja fazën finale të negociatave për ndarjen e posteve e kanë kthyer në pazar dhe kushtëzime joprincipiale. Ai ka thënë se nëse nuk ka marrëveshje mes këtyre dy partive, alternativë reale janë zgjedhjet e reja

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 20 DHJETOR** - Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka thënë se mund të ketë një marrëveshje LV-LDK për bashkëqeverisje në çastet e fundit. Ai ka bërë me dije se kjo marrëveshje mund ta ketë shijen e hidhët për palën që do t'i nënshtrohet shantazhit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se zgjedhjet e reja janë alternativa reale nëse nuk ka marrëveshje koalicioni mes këtyre dy subjekteve politike. "Alternativë praktikisht nuk ka, vetëm teorikisht mund të ndodhë që të nominohet një mandatar i dytë, që nuk është Albin Kurti.

Alternativë reale janë zgjedhjet nëse nuk ka marrëveshje koalicioni. Besoj se marrëveshja do të arrihet por, ndoshta, me shijen e hidhët të imponimit për atë palë që do t'i nënshtrohet shantazhit", ka thënë Maliqi. Ai beson se në marrëveshje në mes të këtyre dy partive do të përfshihet edhe çështja e postit të presidentit të ardhshëm. "Besoj se të paktën për presidentin do të ketë marrëveshje që atë ta propozojë LDK-ja, por që VV-ja ta konfirmojë si propozim të pranueshëm, nëse vlerëson se është personalitet që garanton përfaqësimin e interesave të vendit në përgjithësi dhe nuk është thjesht argat i LDK-së", ka thënë ai. Sipas Maliqit, LV-ja dhe

LDK-ja fazën finale të negociatave për ndarjen e posteve e kanë kthyer në pazar. "Bisedimet kanë qenë kombinim i një qasjeje të re dhe më serioze në bërjen e koalicionit, për faktin se grupet e ekspertëve të dy subjekteve fituese të zgjedhjeve e kanë harmonizuar me sukses dhe pa ndonjë ngërç programin e përbashkët qeverisës. Mirëpo, në fazën finale që prezantohej si më e lehtë, ajo për ndarjen e posteve, procesi është kthyer te mënyra e vjetër e pazareve dhe kushtëzimeve joprincipiale", është shprehur ai, duke shtuar se këto dy subjekte politike kanë mashtruar edhe ndërkombëtarët për marrëveshjen. "Edhe të huajt janë mashtruar me

## KPK-ja dhe Akademia e Drejtësisë, bashkëpunim të mirë në fushën e trajnimeve profesionale

**PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER)** - Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Bahri Hyseni, ka pritur në takim drejtorin e ri ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, Enver Fejzullahu, të cilin e ka uruar për pozitën e re, duke e falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme dhe ofrimin e trajnimeve profesionale nga ana e institucionit që drejton për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për prokurorët.

Kreu i Këshillit dhe ai i Akademisë kanë biseduar edhe

për rrjedhën e realizimit të planeve të trajnimeve të cilat ishin paraparë për këtë vit dhe për planin e trajnimeve për vitin 2020. Po ashtu, në këtë takim u bisedua edhe për ecurinë e trajnimeve të prokurorëve të rinj, të cilët në Akademinë e Drejtësisë janë duke e ndjekur programin e trajnimeve fillestare. Në fund të dy bashkëbiseduesit patën pajtim të përbashkët për vazhdimin dhe shtimin e bashkëpunimit për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial.



# për palën që i nënshtrohet shantazhit



zotimet se marrëveshja është pothuajse e kryer, se po bisedohet për diçka që mund të zgjidhet shpejt. Por, me rrjedhën e kohës u kuptua se nën sipërfaqen e qetë po ndodh shantazhi, ku asnjëra palë nuk e lëshon udhën", ka thënë Maliqi.

**"Epoka e re":** Z. Maliqi, ndonëse është pritur një marrëveshje e shpejtë për bashkëqeverisje në mes të LV-së dhe LDK-së, një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende. Si i keni parë bisedimet e deritashme mes këtyre dy subjekteve politike?

**Maliqi:** Bisedimet kanë qenë kombinim i një qasjeje të re dhe më serioze në bërjen e koalicionit, për faktin se grupet e ekspertëve

të dy subjekteve fituese të zgjedhjeve kanë harmonizuar me sukses dhe pa ndonjë ngërç programin e përbashkët qeverisës. Mirëpo, në fazën finale, që prezantohej si më e lehtë, ajo për ndarjen e posteve, procesi është kthyer te mënyra e vjetër e pazareve dhe kushtëzimeve joprincipiale, që mua edhe pjesën e parë të "harmonizimit" ma bën të diskutueshme, sa e ka qenë ajo në të vërtetë serioze dhe përbashkuese, apo vendim-marrje e tipit që e kemi pasur deri tash kur subjektet i marrin sektorët ministrorë duke i trajtuar si pronë dhe feude të tyre politike, kurse "harmonizimi" reduktohej në logjikën "mos u përzieni në resorët tanë, as ne

nuk do të ndërhyjmë në resorët tuaj". Në këtë qasje edhe kryeministrit shpesh i mbetej vetëm pushteti i menaxhim të tensioneve intersektoriale.

Për opinionin ka qenë tepër zhgënjyese kjo që ndarja e posteve u bë faktor bllokues. Mua më duket se kjo është pasojë e "harmonizimit të programeve" sa për sy e faqe, ndërkaq që synimi kryesor kishte mbetur kapja e sa më shumë të pushtetit ekzekutiv. Sigurisht, për çdo koalicion janë me rëndësi mekanizmat e check's and balance's si kontrolli i ndërsjellë mes dy subjekteve, krahas check's and balance's institucional përmes ndarjes së pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, që nuk duhet të kanë raporte subordinuese. Mua më duket se bisedimet në mes të LV-së dhe LDK-së kanë qenë një garë dinake për dominim që ushqehet nga mosbesimi i ndërsjellë për shkak të raporteve të acaruar nga më herët. Por, ata e tregonin se marrëveshja për qeverisje do të jetë e lehtë, sepse ka qenë ashiqare se verdikti i 6 tetorit praktikisht e mandatonte vetëm koalicionin LV-LDK. Ndërkaq që dy autoritetet kryesore, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, realisht e shtynin deri në ekstrem krijimin e qeverisë për të përfutur nga koncesionet eventuale të ditës së fundit. Kjo sërish e la përshtypjen e një "aksham pazari" të përmbysur. Nëse në vitin 2017 Haradinaj është bërë kryeministër me një "aksham pazar" të ditës së certifikimit, tani marrëveshja po shtyhet deri në vigjilje të ditës së konstituimit të Kuvendit, e proceduralisht do të mund të përbirohet edhe më pas duke mbajtur seancën e Kuvendit me vazhdimë, për ta luajtur finalen me "argument" kushtëzues: o do të lëshoni pe për postin e

presidentit, o shkojmë në zgjedhje të reja. Kjo është esenca e kontestit, kurse gjithçka tjetër retorikë që maskon shantazhin bazë.

**"Epoka e re":** Kush mendoni se po e pengon arritjen e një marrëveshjeje të tillë dhe si duhet të dalin nga ky ngërç këto dy subjekte?

**Maliqi:** Mendoj se po e pengon moskuantifikimi më i saktë i peshës së posteve kyçe, të kryeministrit, të presidentit dhe të kryetarit të Kuvendit. Kot bisedohet për programin e përbashkët nëse nuk e qartësoni peshën e bartësve të roleve për realizmin e atij programi. Këto është dashur të harmonizohen pothuajse njëkohësisht me programin. Në bisedat është dashur të përcaktohet edhe instanca kyçe koordinuese dhe vendimmarrëse e koalicionit, shembull në atë aks që mua më duket më e logjikshëm si raport kryeministër (LV), zëvendëskryeministër i parë (LDK), që do të ketë kontakte të azhurnuara për çdo pjesë të rëndësishme të realizmit të programit qeverisës. Konkretisht, ky bosht mund të shihet si koordinim në mes të Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit, sepse mua më duket e logjikshme që në krye të ekzekutivit të jenë në korrelacion të afërt Albin dhe Vjosa si fitues realë të shumicës për qeverisje të përbashkët. Aty edhe mund të vendoset aksi i mirëbesimit dhe koordinimeve, që të mos ketë ngadalësime, pengime ose edhe bllokada në zinxhirët transmetues dhe potencialisht burokratike të pushtetit. Ka shumë mundësi që të instalohen checks and balances specifike në formulën e këtillë të koalicionit. Se si do të koordinohet pastaj Vjosa Osmani me partinë e vet, dhe Albin Kurti me të vetën, këto

janë çështje dytësore. Më efektive do të kishte qenë nëse për postet dhe raportet e kontrollueshme do të bisedohej që nga dita e parë e harmonizimit të programit qeverisës, e jo që siç ndodhi kontrolli të projektohet në kapjen e postit të presidentit. Për këtë ka kohë një vit e gjysmë të qeverisjes si koalicion funksional.

**"Epoka e re":** Së fundi kemi parë se është shtuar presioni ndërkombëtar për formimin e institucioneve. Sa besoni se do të ndikojë kjo në përsheptimin e formimit të institucioneve?

**Maliqi:** Edhe të huajt janë mashtruar me zotimet se marrëveshja është pothuajse e kryer, se po bisedohet për diçka që mund të zgjidhet shpejt. Por, me rrjedhën e kohës u kuptua se nën sipërfaqen e qetë po ndodh shantazhi, ku asnjëra palë nuk e lëshon udhën.

**"Epoka e re":** Në bazë të asaj që kemi parë deri më tani, prisni një marrëveshje mes këtyre dy subjekteve deri më 26 dhjetor kur do të mbahet seanca konstituive e Kuvendit? Nëse jo, cila është alternativa?

**Maliqi:** Alternativë praktikisht nuk ka, vetëm teorikisht mund të ndodhë që të nominohet një mandatar i dytë, që nuk është Albin Kurti. Alternativa reale janë zgjedhjet nëse nuk ka marrëveshje koalicioni. Besoj se marrëveshja do të arrihet por, ndoshta, me shijen e hidhët të imponimit për atë palë që do t'i nënshtrohet shantazhit. Besoj se të paktën për presidentin do të ketë marrëveshje që atë ta propozojë LDK-ja, por që LV-ja ta konfirmojë si propozim të pranueshëm, nëse vlerëson se është personalitet që garanton përfaqësimin e interesave të vendit në përgjithësi e nuk është, thjesht, argat i LDK-së.

## Haradinaj bëri homazhe në përvjetorin e vdekjes së komandant 'Lulit'

LIPJAN, 20 DHJETOR (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë të premtën homazhe në Hallaq të Vogël të Lipjanit, në përvjetorin e vdekjes së komandant Lulzim Morinës. Me këtë rast, kryeministri në detyrë, Haradinaj, me bashkëpunëtorë, ka nderuar figurën dhe veprën e komandant Lulzim Morinës, duke e vlerësuar si

njërin ndër komandantët më të zotë të luftës çlirimtare. "Lulzim Morina, i njohur gjatë luftës si komandant 'Luli', ishte një ndër më të zotët e Dukagjinit dhe tërë Kosovës. Sot u bëmë bashkë, familja dhe miqtë e Lulit, për ta nderuar e kujtuar veprën e tij heroike. Falë trimave si 'Luli' familjet që i rritën ata dhe i gjithë populli sot gëzojnë lirinë!", ka thënë Haradinaj.



# Përurohen varrezat e 20 martirëve në 100-vjetorin e masakrës së Gurbardhit

**MALISHEVË, 20 DHJETOR (ER)** - Në 100-vjetorin e masakrës së Gurbardhit, ku janë vrarë 22 civilë, të premtën në këtë fshat janë përuar varrezat e rregulluara të kësaj masakre. Në ceremoninë e përuimit të varrezave të rregulluara ka marrë pjesë kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, i cili ishte i shoqëruar edhe nga përgjegjës të drejtorive komunale, nxënës të shkollës dhe qytetarë të shumtë të Gurbardhit. "Rregullimin dhe mirëmbajtjen e këtyre varrezave e kemi obligim, sepse këto varreza janë dëshmia më e mirë e krimeve të bëra mbi popullatën shqiptare. Këto masakra, si e Gurbardhit, dëshmojnë përpjekjet e okupatorëve sllavë për zhdukjen e popullit shqiptar, pasi vrasjet ishin masive, pothuajse

në çdo vendbanim, por ne kemi mbijetuar, sepse Zoti deshi që ne të mbijetojmë dhe luftuam për mbijetesë, sepse ky është vendi ynë dhe kjo është toka jonë", ka thënë Begaj.

Ndërsa në emër familjarëve të pranishmit i ka përshëndetur Haxhi Berisha nga Gurbardhi, i cili e ka falënderuar Komunën e Malishevës për rregullimin e varrezave të 22 martirëve të fshatit Gurbardh që ishin vrarë në pranverën e vitit 1919. 100 vjet më parë forcat e ushtrisë çetnike serbo-malazeze kishin vrarë 22 civilë të fshatit Gurbardh, i cili në atë kohë numëronte më pak se 40 familje.

Të vrarët e kësaj masakre banorët i kishin varrosur në një hapësirë të veçantë, me qëllim të kujtimit të kësaj masakre.



## Lladrovci takohet me kryetarin e Komunës Postonja të Sllovenisë



**DRENAS, 20 DHJETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, gjatë qëndrimit zyrtar në Slloveni, të premtën është pritur në takim nga kryetari i Komunës Postonja, Igor Marentiq, me të cilin ka diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të dy komunave.

Kryetari Lladrovci e ka falënderu-

ar homologun dhe e ka njoftuar për mundësitë që ofron Drenasi për investime. "Parku i Biznesit në Drenas ofron mundësi të mira për investime. Prodhimet nga ky vend mik janë të njohura për qytetarët tanë, andaj biznesmenët sllovenë janë të mirëseardhur për ta ngritur prodhimin e tyre edhe në Kosovë", ka thënë kryetari Lladrovci. Më tutje, ai ka

thënë se bashkëpunimi në mes të dy komunave mund të zgjerohet edhe në aspektin kulturor e arsimor.

Ndërsa kryetari i Komunës Postonja, Igor Marentiq, ka thënë se do t'i shikojë të gjitha mundësitë e bashkëpunimit me Komunën e Drenasit për ta thelluar bashkëpunimin në mes të dy komunave.

## Haziri e Hajrizi diskutojnë për digjitalizimin e shkollave të Gjilanit

**GJILAN 20 DHJETOR (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim rektorin e kolegjit UBT, Edmond Hajrizi, me të cilin ka diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në shumë fusha. Haziri e ka falënderuar rektorin Hajrizi për vizitën, duke ofruar

bashkëpunim të plotë në të mirë të zhvillimit të projekteve për Gjilanin. Gjatë takimit është biseduar për mundësinë e bashkëpunimit në forcimin e platformës "Smart City", për digjitalizimin e shkollave të Gjilanit, për projektet që kanë të bëjnë me Planin Zhvillimor

Urban dhe projekte të tjera të rëndësishme. Rektori Hajrizi e ka falënderuar kryetarin Haziri për pritjen dhe ofrimin e bashkëpunimit, ndërkaq ka theksuar se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi i akademisë me qytetet. "UBT ka frymë proaktive", ka thënë ai.



## Së shpejti hapet kopshti 'Cicërimat' në lagjen 'Kalabria'

**PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER)** - Komuna e Prishtinës ka njoftuar se në lagjen "Kalabria" së shpejti do të hapet kopshti "Cicërimat", i cili ka kapacitet për 100 fëmijë. Në këtë kontekst, kjo komunë ka theksuar se tashmë është hapur edhe konkursi për pranimin e stafit, i cili do të merret me këtë kopsht dhe fëmijët. "Kopshti 'Cicërimat' në lagjen 'Kalabria' së shpejti do t'i hap dyert për rreth 100 fëmijë të lagjes. Fillimisht është hapur konkursi edhe për rekrutimin e stafit të këtij kopshti, të cilët do të përku-



jdesen që ky kopsht të funksionojë dhe t'i zbatojë të gjitha politikat dhe standardet adekuate për edukimin e hershëm", ka njoftuar Komuna e Prishtinës.

## Finalizohet ndërtimi i pendës së ujitjes në lokacionin Jaruha në Junik

**JUNIK, 20 DHJETOR (ER)** - Komuna e Junikut ka bërë me dije se ka arritur fazën finale ndërtimi i pendës së ujitjes në lokacionin Jaruha. Kjo komunë ka njoftuar se kjo pendë ofron infrastrukturë të mirë në sektorin e bujqësisë për lagjet "Krasniqi", "Shalaj" dhe "Gaxherri" të Junikut. "Komuna e Junikut në kuadër të iniciativës 'Shërbime të mira për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik', po krijon kushte të mira infrastrukturore dhe qasje të lehtë për qytetarë për



zhvillim në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Projekti është financuar nga Komuna e Junikut dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", ka njoftuar Komuna e Junikut.

# Rusia është kërcënimi real dhe global i Kosovës (3)

Rusia dhe bota nuk janë as në vitin 1989, as në vitin 1999 apo në vitin 2008. Rusia jo vetëm se do ta mbajë vendin të bllokuar për t'u anëtarësuar në OKB, por do ta vazhdojë luftën kundër Kosovës në nivel ndërkombëtar dhe do të paraqesë kërcënim për stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë



**Dr. Enver HOXHAI**

Sot raportet në mes të shteteve perëndimore dhe Rosisë janë në nivelin më të keq pas fundit të 1989-s. Kjo do të ketë pasojë edhe për Kosovën, por vendi duhet të jetë shumë i qartë në qëndrimet e tij. Acarimi i marrëdhënieve në mes të ShBA-së dhe BE-së në njërin anë dhe Rosisë në anën tjetër pas situatave të shumta ndërkombëtare mund të ketë ndikim drejtpërdrejt në relacionet Kosovë - Rusi. Për më shumë, Rusia do ta rrisë ndërhyrjen në të ardhmen në vendet e saj fqinje dhe kudo tjetër që mundet. Ajo do të vazhdojë të krijojë ndarje të brendshme në këto shtete dhe shoqëri të BE-së dhe jashtë saj. Kontestimi i legjitimitetit të shtetësisë sonë nga një kandidat francez për president si Fransua Fillon, apo një president aktual çek Milosh Zeman, apo një zëvendëskancelar austriak Hainc Kristian-Shtreha, nuk janë aspak ngjarje të izoluar të rastit. Ky i fundit, madje, u konfirmua në një skandal të nxjerrë nga "Der Spiegel" se ishte në shërbim të tërthortë të Rosisë. Në anën tjetër, Fillon kishte qenë shumë i afërt me institute dhe shoqata të miqësisë franceze-ruse në Paris. Para disa vitesh, gjatë një takimi me ish-ministrin e Jashtëm të Moldavisë, kur unë insistoja për njohjen e Kosovës, ai po më shpjegonte gjatë se si konkretisht kushtëzohej vendi i tij dhe Rumania për të mos e bërë një gjë të tillë. Është fjala për rajonin dhe konfliktin e ngrirë në Transdistri të cilën rusët e kanë përdorur edhe si

kartë shantashuese për të mos njoftuar Kosovën. Për herë të parë kisha marrë një shpjegim të gjatë se si Putini duke u paraqitur si gjoja mbrojtës i minoriteteve ruse në Evropën Jug-Lindore, nga Moldavia në Baltik, ndiqte një politikë të krijimit të situatave të konfliktit të ngrirë dhe të zonave të ndërmjetme si zgjatje ruse brenda këtyre shteteve. Një politikë e njohur si "near-abroad" në zona post-sovjetike. Dihet mirëfilli që raporti i këtyre dy vendeve është sikur ai në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Nëse kjo vazhdon edhe në të ardhmen, shtrohet dilema se a do të përpiqet Rusia ta përdorë edhe më tutje Kosovën si rast krahasues në luftën e saj dhe ta justifikojë ndërhyrjen në rajonet përreth saj duke bërë paralele për politikën e saj agresive. Moska do të mbështesë rajone dhe lëvizje secesioniste në shtete të ndryshme për t'i kushtëzuar ato në sjelljen e tyre të jashtëme. Kështu, kur Putini përsëri foli për Kosovën në Klubin Vallдай iu kthye narracionit të standardeve të dyfishta të perëndimit, veçanërisht të BE-së në raport me Kosovën. I dha mbështetje të plotë lëvizjeve secesioniste në Kataloni, mandej edhe në Kurdistan, me qëllimin sa ta godasë vendin tonë dhe njëkohësisht komunitetin ndërkombëtar perëndimor. Marrëdhëniet e Rosisë me Perëndimin janë, po ashtu, komplekse. Ato karakterizohen me motive, me shumë fusha të ndërveprimit, por edhe përplasje. Nga perspektiva ruse, rivalja e tyre kryesore globale ka qenë dhe mbetet Amerika. Ndërsa në nivelin evropian dhe euroatlantik mbeten BE-ja dhe NATO-ja. Me paramendim Rusia sillet si një rivale e Perëndimit në Evropën Lindore dhe kudo tjetër. Përveç rivalitetit në Evropën Lindore, po ashtu edhe në Ballkan mbetet një arenë e rivalitetit

rus-perëndimor siç edhe është dëshmuar përgjatë historisë. Interesi kyç rus në rajon duket se do të mbetet edhe në të ardhmen, që të mbahet rajoni në një gjendje të status-quo. Që këto vende të rajonit të mbesin një periferi e skajshme e BE-së, të pazhvilluara dhe të pamodernizuara. Ndërhyrja ruse në Ballkan pritet të ndodhë edhe në të ardhmen përmes promovimit të një uniteti pansllav dhe pan ortodoks, ku disa shtete të rajonit mund të përafrohen me Rusinë si kundër-balancë karshi vendeve të tjera, më të qarta në orientimin perëndimor si Sllovenia, Kroacia, Kosova dhe Shqipëria. Po ashtu, Rusia do të synojë që ta rrisë ndërvarësinë e rajonit edhe në të ardhmen përmes shtrirjes së rrjeteve gazsjellëse, investimeve kapitale në vende të rajonit si dhe ofrimit të përkrahjes politike. Ajo nuk është një kërcënim imagjinar, por një kërcënim real. Ajo pret që Ballkani të jetë sa më i jo stabil dhe të shndërrohet në vijë të ballafaqimit politik, ekonomik dhe kulturor. Raportet e Kosovës me Rusinë kanë qenë deri më tani të determinuara nga marrëdhëniet Perëndimit me Moskën. Edhe relacionet e ardhshme të Kosovës me Rusinë do të varen kryesisht nga marrëdhëniet e Rosisë jo vetëm me Serbinë, por mbi të gjitha me Perëndimin. Sa i takon Serbisë, Rusia do të vazhdojë të mbajë lidhje të veçanta të bazuara në histori e fe, sidomos për shkak të bashkëpunimit ekonomik, politik dhe ushtarak. Ajo që mbetet të shihet është nëse gjatë procesit të integritetit të Serbisë në BE, do të ndodhë ndonjë zbehje e lidhjeve aktuale të forta serbo-ruse. Deri më tani ka qenë e kundërta nën udhëheqjen e Aleksandër Vuçiqit. Ndër pyetjet qenësore për shoqërinë serbe është se gjatë procesit të kushtëzuar të evropianizimit a mund të ndodhë jo vetëm një largim nga nacionalizmi i deritanishëm, por edhe një zvogëlim i ndikimit rus në Serbi? Deri me sot jo. Në anën tjetër, a do ta përdorë Rusia edhe Serbinë në BE si "lojtare" të saj për të ushtruar ndikim brenda institucioneve evropiane, nëse kjo e fundit një ditë do të bëhej pjesë e saj. Meqë Serbia është e kushtëzuar të arrijë marrëveshje obliguese ligjore me Kosovën para anëtarësimit në BE, kjo mund të jetë mundësia që Rusia ta zbusë qëndrimin ndaj anëtarësimit të

Kosovës në OKB. Disa politikanë e diplomatë rusë, kanë përsëritur qëndrimin se vendi i tyre nuk është i shqetësuar se a është Kosova e pavarur apo jo, por se ata ndjekin interesat e tyre në raport me Kosovën. Mund të ndodhë që edhe nëse arrihet marrëveshja me Serbinë, Rusia ta bllokojë përsëri Kosovën për shkak të interesave të saj gjeopolitike. Sido që të jetë, Kosova nuk duhet të sillet si në të kaluarën ndaj Rosisë. Ajo duhet ta rivlerësojë qasjen ndaj saj. Rusia dhe bota nuk janë as në vitin 1989, as në vitin 1999 apo në vitin 2008. Rusia jo vetëm se do ta mbajë vendin të bllokuar për t'u anëtarësuar në OKB por do ta vazhdojë luftën e saj kundër Kosovës në nivel ndërkombëtar dhe do të paraqesë kërcënim për stabilitetin dhe sigurinë në Kosovë. Liderët serbë mund të kenë përfitime afatshkurta nga Rusia me veton e saj në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, duke penguar njohjen e plotë ndërkombëtare të Kosovës. Çfarë mbetet të shihet është se cilat janë kostot e miqësisë ruso-serbe për Beogradin, apo edhe për Kosovën. Si përfundim: Rusia që nga paraqitja e çështjes së Kosovës në vitet '90, pas vendosjes së saj nën protektoratin ndërkombëtar, si dhe pas pavarësisë e deri më sot, ka shndërruar ekzistencën tonë si shtet të përplasjeve të fuqive të mëdha. Meqë Kosova ka qenë temë e ballafaqimit global, është koha e fundit që të mendohet për një përgjigje lokale, në nivel vendor. Qasja e Kosovës në raport me ndikimin rus duhet të jetë në dy nivele, aq sa kemi mundësi, resurse, dhe imagjinatë. Së pari, në raport me katër komunitetë në veri të Kosovës. Meqë sikurse shumë veprime deri më tash në këtë pjesë të saj kanë treguar, Rusia do të mundohet ta përdorë këtë pjesë në shahun e saj gjeopolitik. Mundësisht do të bëjë përpjekje që ta mbanë si një zonë e konfliktit të ngrirë, e pa integruar plotësisht në Kosovë. Për më shumë, janë një listë e gjatë e rasteve në vitet e fundit që tregojnë që rusët operojnë me qasje të padukshme në veri të vendit për ta përdorë këtë për ta destabilizuar Kosovën. Nuk ka qenë fare rastësi kur përpjekja për puq në Podgoricë përfshiu edhe disa serbë nga veriu i Kosovës, që ishin pjesë e skenarit rus për ta destabilizuar dhunshëm këtë vend. Apo raste

të konvojeve humanitare ruse, apo turne të çiklistëve rusë me dukje të formacioneve paramilitare. Së dyti, Kosova si shtet duhet ta ndërtojë një mendim të plotë strategjik të ballafaqimit me Rusinë në planin politik, diplomatik, medial dhe digital. Përsëri, këtu aq sa kemi mundësi dhe jemi në gjendje të veprojmë. Duhet të shohim se në cilat vende dhe në cilat organizata ka gjasa që Rusia ta godasë vendin tonë, para se kjo të ndodhë. Reagimi i fundit i Putinit ka qenë në raport me vendimin për transformimin e FSK-së në ushtri dhe duhet të shihet se si ky vendim të shpjegohet tek vendet jo-njohëse dhe me gjeografi të largët. Siguria kibernetike gjithashtu është një sfidë dhe kjo kërkon një qasje ndërinstitucionale meqë imagjinata jonë mund të jetë e varfër në raport me goditjen e mundshme ruse. Disa herë shërbimi i jashtëm i Kosovës ka qenë target i sulmeve kibernetik, nga çka mund të nxirren mësim për të ardhmen. Përpjekje ka, po ashtu, për penetrim në sistemin bankar përmes vendeve të cilat e kanë njohur Kosovën, por të cilat mund të jenë platforma për depërtim të kapitalit financiar rus. Tregimi rus për Kosovën do të vazhdojë duke prezantuar shoqërinë e Kosovës të përbërë nga islami radikal, nga OKB-ja, OSBE-ja, e deri tek organizata e shteteve në kontinente të ndryshme. Për ballafaqim në të ardhmen me Rusinë, rol të madh do të mund ta luajnë edhe mediat, shoqëria civile dhe universitetet. Si një vend i integruar pjesërisht në sistemin ndërkombëtar, kjo për shkak të Rosisë, Kosova, krahas një qasjeje vendore, ka nevojë edhe mbështetje të fuqishme nga evropianët dhe amerikanët në ballafaqim me luftën hibride. Nëse Rusia deri më tash e ka izoluar Kosovën ndërkombëtarisht, edhe qasja jonë dhe e aleatëve tanë duhet të jetë se si ky vend po ashtu të izolohet. Kjo do të thotë, parandalim i çfarëdo ndikimi rus në Kosovë. BE dhe NATO në të ardhmen mund të jenë bashkim edhe më i fortë politik dhe ushtarak, por nuk mund të luajnë askund jashtë Evropës rol më vendimtar sesa ta shndërrojnë parandalimin e ndikimit rus dhe balancimin kundër Rosisë një prioritet në Ballkan. (Fund)



## Guvernatori Mehmeti ndan certifikatat për 31 studentët që përfunduan programin e praktikës në BQK



PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka ndarë të premten certifikatat për studentët e universiteteve dhe kolegjeve që përfunduan me sukses programin

e praktikës për vitin 2019 në BQK. "BQK-ja është e përkushtuar ta mbështesë programin e praktikës për studentë, përmes të cilit po synojmë ta ofrojmë mundësinë për studentët që të mësojnë për praktikatat më të mira ndërkom-

bëtare që aplikohen në institucionin tonë", ka thënë guvernatori Mehmeti.

Studentët kanë falënderuar stafin e BQK-së për gatishmërinë që t'u ndihmojnë në kryerjen me sukses të praktikës nga e cila kanë mësuar

rreth funksionimit të departamenteve që funksionojnë në kuadër të BQK-së.

Gjatë periudhës korrik-gusht studentët e përzgjedhur janë vendosur nëpër njësi organizative të caktuara të BQK-së dhe kanë punuar

nën udhëzimet e mbikëqyrësve të njëjësive përkatëse. Përzgjedhja e kandidatëve të suksesshëm është bërë duke marrë parasysh rezultatet e tyre në studime dhe shkallën e motivimit për të bërë praktikë profesionale në BQK.

## ZKA-ja: S'ka siguri se ushqimi në treg është mjaftueshëm i kontrolluar dhe i sigurt



**EPOKA ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka bërë publik raportin e performancës "Siguria e ushqimit, rast studimi: produktet e mishit dhe të grurit". Raporti konstaton se institucioni përgjegjës Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) ende nuk e ka plotësisht funksional sistemin e

sigurisë në tërë zinxhirin ushqimor dhe për pasojë nuk ka siguri se ushqimi në treg është mjaftueshëm i kontrolluar dhe është i sigurt për konsumatorin.

Gjetjet e auditimit nxjerrin në pah mangësitë në procesin e planifikimit të kontrolleve dhe mungesën e analizës së rreziqeve.

Në raport thuhet se vlerësimi i sigurisë në ushqim përmes listave të kontrollit nuk i përfshinë të gjitha

parimet e Analizës së Rrezikut dhe Pikave të Kontrollit Kritik (HACCP). Për më tepër, as Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë nuk është i akredituar për të gjitha analizat e nevojshme për siguri në ushqim. Pos kësaj, edhe mënyra e marrjes së mostrave në pikat inspektuese kufitare nuk ofron mjaftueshëm siguri se produktet të cilat hyjnë në treg kontrollohen si duhet dhe sipas procedurave të

vendosura.

Raporti thekson se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë ende nuk i ka kompletuar procedurat dhe standardet e nevojshme për të siguruar se inspektorët sanitarë dhe fitosanitarë janë duke kryer kontrolle zyrtare në pajtim me standardet e sigurisë për ushqim. Auditimi konkludon se inspektorët komunalë nuk janë transferuar në Agjencinë e Ushqimit dhe

Veterinarisë si dhe nuk ka koordinim të mirë të kontrolleve mes nivelit qendror dhe lokal.

Zyra Kombëtare e Auditimit i rekomandon Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë që të kryejë kontrolle cilësore, duke siguruar zbatimin e parimeve të Analizës së Rrezikut dhe Pikave të Kontrollit Kritik (HACCP), të cilat janë bazë për të ofruar siguri në ushqimin për konsumatorë.

## 'Hidrodrini': Konsumatorët të kenë kujdes për instalimet dhe ujëmatësit

PEJË, 20 DHJETOR (ER) - Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Hidrodrini' në Pejë, në prag të mbylljes së vitit kalendarik 2019, ka falënderuar të gjithë konsumatorët e njësive që mbulon, Pejë, Deçan, Istog, Klinë dhe Junik, për pagesa të shërbimeve të ujësjellësit dhe ka ftuar të gjithë konsumatorët

që të jenë sa më të rregullt në pagesa, meqë vetëm në këtë mënyrë mund t'u shmangen masave detyruese ligjore, gjegjësisht ekipeve të shqyrcjes dhe procesimit të lëndëve të përmbaruesit privatë. "Kompania Rajonale e Ujësjellësit 'Hidrodrini' të gjithë konsumatorëve që kanë qenë

dhe janë konform afateve ligjore u ka ofruar dhe u ofron bashkëpunim dhe lehtësira të ndryshme për pagesën e borxheve të mëdha të akumuluar (pagesë me këste mujore prej 12 deri në 36 muaj varësisht nga borxhi i tërësishëm)", është bërë me dije në njoftimin e kësaj kompanie.



## Rukiqi: Me formimin e qeverisë do të përfshihen edhe institucionet në digjitalizim



EPOKA  
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka mbajtur të premten konferencë për medie, në të cilën ka prezantuar raportin "Transformimi digjital i NVM-ve në Kosovë, sfidat dhe mundësitë". Ky raport është i pari i këtij lloji që analizon gjendjen në sektorin e prodhimit, sektorin e shërbimeve, sektorin e bujqësisë dhe shfaq sfidat që hasin bizneset gjatë digjitalizimit.

Kryetari i OEK-ut, Berat Rukiqi, ka deklaruar se digjitalizimi është çështje e domosdoshme për të qenë pjesë e pakos transformuese të ekonomisë së vendit. Sipas tij, ky projekt duhet të jetë më afatgjatë. "Ky projekt ka rëndësi se po bëhet me qeverinë gjermane. Ne po hyjmë jashtë asaj tradicionales në një fushë krejt të re dhe që është pjesa e digjitalizimit, që nënkupton mendësinë e të bërit biznes. Kjo është çështje e domosdoshme", është shprehur ai. Rukiqi ka deklaruar se në

pjesën e parë të vitit të ardhshëm do të formohet qendra për transformim digjital e cila do të veprojë me kapacitet të plotë. "Ne këtë proces e kemi dizajnuar në disa faza dhe pas kësaj në pjesën e parë të vitit të ardhshëm do të formohet qendra për transformim digjital dhe do të veprojë me kapacitet të plotë. Pjesë e punës do të jetë edhe pjesa e informimit të kompanitë", ka thënë Rukiqi. Sipas tij, me formimin e qeverisë do të përfshihen edhe institucionet në digjitalizim.

"Në momentin që do ta kemi qeverinë e re do të jetë përfshirja e institucioneve në digjitalizim", ka thënë ai. Eksperti për digjitalizim, Gerd Meier zu Koecker, ka thënë se transformimi digjital i sjell dobi ekonomisë për të konkurruar me vendet e tjera. "Është e nevojshme që digjitalizimi të fillojë, sepse transformimi digjital i sjell dobi ekonomisë", ka theksuar ai. Ai ka thënë se një nga të gjeturat e këtij raporti është se disa kompani po luftojnë për t'i plotësuar nevojat


dhe kërkesat e klientëve. "Digjitalizimi mund të arrijë që ata të bëjnë punë më të mirë", ka thënë ai. Eksperti vendor për digjitalizim, Dren Selimi, ka pohuar se kompanitë e kanë të domosdoshme të investojnë në promovimin e digjitalizimit. "Njëra prej kompanive rreth sukseseve të tyre në digjitalizim ka qenë fabrika e gypave në Gjakovë 'Inova'. Pra, është një plus në treg që të rritet shpejtësia e infrastrukturës së internetit", ka deklaruar Selimi.

## Tërhiqet nga shitja parcela "Rogova"

Prishtinë, 20 dhjetor (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka bërë me dije se ka tërhequr nga SHAL 53: 'Njësinë nr. 63-KB Rogova, Parcela nr. 639-0 në ZK Rogovë I', me numër rendor 63, prona në ZK Rogovë, Komuna e Gjakovës. "Kjo njësi ishte paraparë të shitej përmes shitjes së aseteve

përmes Likuidimit nr. 53, me numër rendor 63, e cila do të mbahet më 26 dhjetor 2019, ndërsa tërheqja nga tenderi i kësaj njësie është bërë në bazë të shkresës nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër Komuna e Gjakovës. Ndërkaq lista e aseteve që janë në shitje përmes shitjes së aseteve nr. 53 përfsh-

inë 123 asete të ndërmarrjeve shoqërore nga regjione të ndryshme të Kosovës. Dorëzimi i ofertave do të mbahet më 26 dhjetor 2019 nga ora 10:00 deri në orën 12:00, kur edhe do të mbahet ceremonia e hapjes së ofertave, në 'Grand Hotel', duke filluar nga ora 12:30", thuhet në njoftimin e AKP-së.





## Të shtëna në Amerikë, dy të vdekur e dy të plagosur

WASHINGTON, 20 DHJETOR - Dy persona u vranë dhe dy të tjerë u plagosën nga një seri të shtënash të premtën në një ndërtesë qeveritare në Karolinën e Veriut.

Mësohet se viktimat janë punonjës të administratës shtetërore. Të lënduarit nuk janë në gjendje kritike për jetën. Situata është qetësuar tani, dhe zyrtarët thonë se nuk ka


më asnjë kërcënim për publikun. Të shtënat kanë shkaktuar panik të madh mes punonjësve në ndërtesë, të cilët kanë nisur të vrapojnë për të gjetur një strehim

të sigurt. Policia nuk ka dhënë ende detaje të mëtejshme mbi ngjarjen, por pritet të japë më vonë sqarime gjatë një konference me gazetarë.



# Presidenti Trump në qendër të debatit të kandidatëve demokratë

Të gjithë sfiduesit që synojnë kandidaturën në mesin e demokratëve për t'u përballur me presidentin Trump në zgjedhjet e vitit të ardhshëm, thanë se e mbështesin miratimin e akuzave ndaj tij nga Dhoma e Përfaqësuesve, për shpërdorim të pushtetit dhe pengim të Kongresit, duke e cilësuar si udhëheqës në të korruptuar në historinë e vendit



WASHINGTON, 20 DHJETOR - Shtatë kandidatët kryesorë demokratë për zgjedhjet presidenciale amerikane u përfshinë në një debat të nxehtë të enjten mbrëma, duke e cilësuar presidentin Donald Trump si udhëheqës në të korruptuar në historinë e vendit.

Të gjithë sfiduesit që synojnë kandidaturën demokrate për t'u përballur me presidentin Trump në zgjedhjet e vitit të ardhshëm, thanë se e mbështesin miratimin e akuzave ndaj tij nga Dhoma e Përfaqësuesve, për shpërdorim të pushtetit dhe pengim të Kongresit, ka njoftuar voa. "Ne duhet të përtërijmë integritetin e presidencës", tha ish-nënpresidenti Joe Biden, i cili edhe më tej kryeson në anketat kombëtare

për të qenë kandidat i demokratëve. Më vonë, Bideni, duke komentuar ndarjen e mprehtë politike në mes të republikanëve dhe demokratëve që është thelluar në tre vitet e presidencës së Trumpit, tha se refuzon "të pranojë pikëpamjet që ne kurrë nuk mund të bashkohemi përsëri".

Senatori nga Vermonti, Bernie Sanders, që e përshkruan veten si demokrat socialist dhe i cili renditet i dyti pas Bidenit në shumë anketa, e quajti presidentin Trump "një gënjeshtar patologjik" i cili "i ka shitur njerëzit punonjës të këtij vendi".

Senatori Elizabeth Warren nga Massachusetts e përshkroi presidentin Trump si "presi-

dentin më të korruptuar të shekullit". "Presidenti nuk është mbreti i Amerikës", tha senatorja Amy Klobuchar nga Minnesota. Ajo krahasoi veprimet e presidentit Trump për t'i kërkuar Ukrainës që të hetojë Bidenin dhe të birin, me skandalin e korrupsionit politik Watergate të viteve të 70-ta, që çoi në dorëheqjen e presidentit Richard Nixon, pasi u përball me shkarkimin.

Pete Buttigieg, nga South Bend, Indiana, tha se presidenti Trump "e ka bërë të qartë se nuk do të ndalet para asgjëje për të ruajtur pushtetin". Gjatë tërë debatit që u mbajt në universitetin në Los Angeles, kandidatët përsëritën sulmet ndaj Trumpit si president i dështuar. Në të rrallë ata sulmuan edhe njëri-tjetrin. Biden dhe Sanders, debatuan ashpër për sigurimet shëndetë-

sore. Senatori Sanders mbrojti fuqishëm propozimin e tij për një program të përgjithshëm të sigurimit shëndetësor të drejtuar nga qeveria, ndërsa ish-nënpresidenti Biden vazhdoi të bëj thirrje për reforma më të matura që do të lejonin amerikanët të bashkoheshin me një plan qeveritar. Debatit i radhës do të mbahet më 14 janar të vitit 2020 në universitetin Drake në Des Moines.

## Ligjvënësit britanikë mbështesin planin e Johnsonit për Brexit



LONDËR, 20 DHJETOR - Ligjvënësit britanikë e mbështetën planin e kryeministrit Boris Johnson për daljen e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian, më 31 janar. Ata votuan me 358 vota për dhe 234 kundër Marrëveshjes së Tërheqjes.

Dokumenti do të kalojë tani për miratim në Dhomën e Lordëve. Johnsoni tha se marrëveshja i mundëson Britanisë "të ecë përpara".

Udhëheqësi i Laburistëve opozitarë, Jeremy Corbyn, u bëri thirrje ligjvënësve që të votojnë kundër

marrëveshjes, duke thënë se ka "mënyra më të mira dhe më të drejta" për të lënë BE-në.

Por, votimi i së premtës shihet si fitore për Johnsonin, i cili i fitoi bindshëm zgjedhjet e përgjithshme të javës së kaluar me premtimin se do ta nxjerrë Britaninë nga BE-ja. Referendumi për dalje nga blloku evropian, apo Brexit, është mbajtur në vitin 2016. Por, realizimi i procesit është shtyrë disa herë për shkak të mosmarrëveshjeve të brendshme politike mbi kushtet e divorcit.

## Autoritetet turke dëbojnë 110 terroristë të huaj

STAMBOLL, 20 DHJETOR - Turqia ka deportuar 110 luftëtarë të huaj terroristë në vendet e tyre që nga muaji i kaluar, konfirmoi një zyrtar i Ministrisë së Brendshme turke. Nga 46 evropianët e dëbuar,

21 ishin shtetas gjermanë. Zyrtari konfirmoi një numërim gjithëpërfshirës nga agjencia shtetërore turke e lajmeve, Anadolu Agency (AA), që tha se janë kthyer 13 shtetas francezë dhe pesë bri-

tanikë, si dhe nga dy shtetas nga Belgjika, Holanda, Kosova dhe Maroku. Gjithashtu u riatdhesua një qytetar nga secili prej vendeve, ShBA, Greqi, Danimarkë, Irlandë dhe Australi.

Deri më tani, Turqia ka përfshirë në dëbim edhe fëmijë. Dëbimet kanë nisur më 11 nëntor, por ministria nuk ka specifikuar nëse të gjithë të dyshuarit ishin të lidhur me grupin ekstremist të Shtetit



Islamik dhe as nuk ka dhënë detaje për akuzat kundër tyre.

Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (12)

# 15 DITË NË SPITAL, MANDEJ NË BURGUN USHTARAK TË NISHIT



LULZIM SAHITI

Pasi arrijnë në qytetin e Nishit, Enver Krasniqi dhe Azem Sumën i dërgojnë për shërim të plagëve të luftës në Spitalin Ushtarak të Nishit, kurse pesë ushtarët e tjerë në Burgun Ushtarak të Nishit. Mjekët serbë, pasi i kishin kontrolluar pacientët e zënë rob, kishin konstatuar se Azem Suma ka dy plumba në këmbë, ndërsa Enver Krasniqi pesë plumba në pjesë të ndryshme të trupit. Të dytë kishin humbje të një sasi të konsiderueshme të gjakut, gjë që janë detyruar të marrin gjak si dhe i kanë operuar plagët në këtë spital. Në përgjithësi, eprorët ushtarakë serbë në spital kishin sjellje korrekte dhe ishin treguar të kujdesshëm për shërimin e

plagëve të tyre. Ndërsa disa ushtarë të thjeshtë, pa praninë e eprorëve, silleshin shumë keq, duke i provokuar vazhdimisht dhe fyer në komb. Gjatë qëndrimit në spital gjykatësit hetues i kanë kërcënuar disa herë se do t'i dënojnë nga 15 deri 20 vjet burg. Pas tretmanit mjekësor pesëmbëdhjetëditorë, dy të plagosurit dërgohen në paraburgim në Burgun Ushtarak të Nishit.

Në këtë burg nga 17 dhjetori mbaheshin edhe Blerim Spahiu, Ismet Mazreku, Merita Ramadani, Nazmi Bellaqa, Samet Ballazhi, Sherif Bellaqa dhe Xhavit Krasniqi i sjellë në këtë burg më 18 dhjetor.

Ushtari Sherif Bellaqa në dhomën e burgut kishte gjetur dy të burgosur (ushtarë serbë) që kishin dezertuar nga Ushtria Jugosllave. Njëri fliste gjuhën shqipe, meqë vinte nga Obiliqi. Ai kishte treguar se tri herë radhazi ka dezertuar nga vendluftimet që zhvilloheshin në trevën e Rahovecit, kurse tjetri ishte nga Smedereva e Serbisë.

Pas operimit në spital, Enver Krasniqi e dërgojnë në burg natën e Vitit të Ri më 31 dhjetor. Ndërkohë ia dërgojnë në dhomë një ushtar serb që kishte dezertuar nga Ushtria Jugosllave, i cili

përndryshe kishte ikur nga lufta në Kosovë. Ai vinte nga Krushevc i Serbisë, mirëpo ishte një djalë shumë i mirë dhe human. Ishte kujdesur ndaj Enverit për t'ia bërë pastrimin e plagëve, pastaj i hiqte jashtëqitjen, meqë ai nga plagët që kishte nuk mund të lëvizte dot. Madje, me të hollat e veta i blinte edhe cigare.

Prokurori ushtarak në Nish më 17. 12. 1998 kishte parashtruar kërkesën në Gjykatën Ushtarake në Nish për zbatimin e hetimeve kundër pjesëtarëve të UÇK-së: Ismet Mazreku, Enver Krasniqi, Azem Suma, Blerim Spahiu, Sherif Bellaqa, Samet Ballazhi dhe Nazmi Bellaqa. Të gjithëve u vihet në barrë vepra penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi 10 vjet e më shumë burgim. Këta të gjithë janë akuzuar se në gjysmën e dytë të vitit 1998 kanë kaluar ilegalisht në Republikën e Shqipërisë me qëllim të furnizimit me armë dhe përgatitje tjetër për nevoja të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe se në grupin e më se 150 personave më 14 dhjetor 1998 në mes të orës 02-03 kanë tentuar që ilegalisht të hyjnë në territorin e RFJ-së, në rajonin e gjerë të Karakollit "Liken", duke bartur me vete sasi të madhe armësh dhe municion,

armatim dhe përgatitje tjetër ushtarake për nevoja të UÇK-së në Kosovë. Gjykatës hetues ishte togeri Zdravko Dordevicq, ndërsa lënda për Merita Ramadani dhe Xhavit Krasniqi ishte veçuar ngase ata ende ishin të mitur.

## 8 JANAR 1999 - UÇK ZURI ROB TETË USHTARË SERBË

Rreth orës 11:00 ushtarët e Zonës Operative të Shalës të UÇK-së, më 8 janar të vitit 1999, kanë zënë rob tetë ushtarë serbë, të cilët më 13 janar u shkëmbyen me nëntë ushtarë të UÇK-së, të zënë rob nga forcat serbe në Pashtrik të Prizrenit. Nga pjesëtarë të Policisë Ushtarake dhe të Njësitit Special të Brigadës 141 "Mehë Uka" të Zonës Operative të Shalës, në një aksion në fshatin Bare të Mitrovicës arrin që t'i zënë të gjallë 8 ushtarë serbë:

1. Dragan Jugović, rreshter i vjetër
2. Ivan Kostić, dhjetar
3. Aleksandar Milašinović, dhjetar
4. Robert Čekanović, ushtar
5. Nikola Cvijović, ushtar
6. Marko Pavlović, ushtar
7. Nenad Jovičević, ushtar
8. Aleksandar Subotić, ushtar.

Pas kësaj ushtria serbe kishte dhënë ultimatum që deri në orën 15:00 të asaj dite të lirohen pa kurrfarë kushti. Por, UÇK-ja kishte vendosur që lirimi i ushtarëve serbë të kushtëzohet me lirimin e nëntë ushtarëve të UÇK-së që ishin kapur tri javë më parë nga forcat serbe në Pashtrik. Më pastaj me ndërmjetimin ndërkombëtar arrihet marrëveshja për shkëmbimin e pengjeve të luftës. Lirimi ishte rezultat i bisedimeve katërorëshe midis përfaqësuesve të Shtabit të UÇK-së: Jakup Krasniqi, Ramë Buja, Sokol Bashota dhe delegacionit ndërkombëtar në përbërje: William Walker, shef i Misionit të OSBE-së (KVM-së), Christopher Hill dhe Wolfgang Petrisch, ndërmjetës ndërkombëtar për Kosovë. Kështu, më 13 janar 1999 lirohen 8 pjesëtarët serbë, ndërsa dhjetë ditë më vonë, sipas marrëveshjes dhe garancisë së faktorit ndërkombëtar, më 23 janar lirohen edhe 9 pjesëtarët e UÇK-së. Kjo përbënte një fitore të madhe politike, ushtarake dhe diplomatike për UÇK-në ngaqë kishte bërë trajtimin e njerëzishëm ndaj tetë robërve të luftës, gjë që ishte dëshmuar edhe nga rrëfimet e vet ushtarëve jugosllavë. (Vijon)



Nëntor 1998. Fotografi e realizuar përballë Kazermës së UÇK-së në Vlahën



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
HALAL FOOD

**PASHTETË PULE**

gluten free



**cilësi e garantuar**

pa konservues

# LIBËR ME KOD PRITJEJE PËR KUJTESËN HISTORIKE

- Adem Zaplluzha, "Kur qajnë pemët", "Trend", 2016



Prof. dr. Sabile KEÇMEZI-BASHA

Nis Peterson, poet danez, duke folur për rëndësinë e poezisë, thotë: "Mëso, se kur mungon fantazia, sundojnë vrazhdësia, egoizmi, vdekja. Mëso se pa poezinë njeriu nuk do të ishte i aftë për ndjenja të thella si: besimi, patriotizmi, malli ose synimi për një botë të përkryer. Është pikërisht fantazia ajo që gris perden para syve tanë dhe i aftëson ndjenjat tona duke na bërë të zotë të depërtojmë në thelbin e botës që na rrethon". Dhe, shtrohet pyetja, Adem Zaplluzha, është poet, shkrimtar, humanist, tregimtar, romancier, dramaturg, apo që të gjitha i ka me bollëk? Duke e njohur njeriu e penës e të shkrimtarisë jo vetëm në Kosovë në veçanti, por edhe në të gjitha trojet shqiptare në përgjithësi, nuk hezitova fare që të jem redaktore e recensente e librit të tij me poezi... i 125-ti me radhë.

Kam lexuar shumë nga shkrimtari i nderuar Adem Zaplluzha. Dhe asnjëherë nuk më ka ndodhur që me mbyllet e librit të mbyllet edhe jehona e vargjeve të tij. Se libri i shkrimtarit... është një vëllim me poezi vlerash të veçanta, që nuk kontestohet dhe përmes përmbajtjes së tyre (poezive) ai trajton tema e motive, sa të dhembshme aq edhe të rëndësishme për

kohën e momentin të cilën po e jetojmë. Idetë e mesazhet që sjell me anën e poezive janë të qarta dhe të lënë për Adem Zaplluzhanjë kohë të mendosh gjatë për fatin e kombit e të kombeve. Zaplluzha duke qenë i përgatitur në bërjen e poezisë, ai gjithkund në poezi rrok në pasqyrim çështje e probleme të kohës të gërshetuara në varg mbresëlënës dhe, duke hedhur dritë në dukuritë që kanë frymëzuar-objektivisht autori, vihet në shërbim të idealeve dhe të shpresave të njerëzve, të cilët përmes shiut, zogjve, kullave, ëndrrave, plepave, lumenjve, cerberëve, katallanëve aspirojnë t'i përmbushin dëshirat me qëllim të sfidimit të së keqes, territ-burg, padrejtësive që kanë ndodhur si në të ikur, në të tanishmen, po edhe që përgatitën për të ndodhur në ditën e ardhshme.

Andaj, në poezinë e Adem Zaplluzhës përditshmëritë duken të zymta, anemike, të vrenjtura dhe, si të tilla, qëndrojnë pezull mbi kokat tona, bile mund të themi se kjo kohë e zymtë dalë



ngadalë po i gërryen edhe muranat e kujtesës, (poezia Po i gërryen muranat e kujtesës). Autori i vargjeve i nxënë ngushtë, në një poezi tjetër, pikërisht nga kjo monotoni e ditës, inferioritetit të imponuar dhe romuze gjithë faresh, vetëm sa nuk do të bërtas Këtu edhe netët lehin, poezi me të njëjtin titull. Porosia e të gjitha cikleve me poezi, ani se në mes rreshtash,

na vjen shumë e qartë edhe kur (siç shohim edhe tek poezitë tjera, si: Përngjajnë me njerëzit sy uritur; Nga një mallkim i keq; Mes rrënjëve fshihen të reshurat etj. Nga shumë përgjigje të munguara, mbesim pa fjalë, memecë në kohë, e cila parakalon para syve tanë ku, mungojnë reagimet e pritura edhe kur e dimë se historia e jonë fletë me gjuhën e fakteve.




## 'DHIMBJET S'I MERRTE ASKUSH' DEL NGA SHTYPI

PRISHTINË, 20 DHJETOR - Ka dalë nga shtypi libri me poezi Dhimbjet s'i merrte askush i Ramë Bashotës. Sipas botuesit, Berat Armagedonit, dhimbjet në këtë libër nuk janë dhimbje fizike, "por janë shpirtërore. Nuk janë vetëm të autorit, por janë të shokëve, të popullit e të kombit të tij. Meqë janë të tjetërlojta, të forta, të padurueshme, që s'u gjendet askund ilaç për shërim, s'i merr askush. I mbeten autorit, në mendje dhe gjuhë, që t'i trajtojë poetikisht, me varg të matur e me strofë klasike, edhe kur është larg vendlindjes, edhe kur është në truallin e familjes. Mbase ilaçi për shërim të dhimbjeve është

shkrimi! Është poezia. Këtë dëshmi shërimi e solli Ramë Bashota në mesin tonë". Libri ka katër cikle, rreth 80 poezi.

### SHËNIME PËR AUTORIN

Ramë Bashota është nga Komuna e Klinës. Ka të kryer Shkollën e Lartë Pedagogjike në Gjakovë. Disa vjet ka punuar në arsim. Ka nisur të shkruajë e të botojë poezi që kur ka qenë nxënës në shkollën e mesme. Fati i tij, ashtu si krijimtaria e tij poetike, u përball me burgosje, me luftë dhe me dëgjie dorëshkrimesh në luftën e viteve 1998-'99 në Kosovë. Ky është libri i tij i dytë. Autori jeton dhe punon në Francë.



## Tri projekte filmike nga Kosova mbështeten në Shqipëri dhe Maqedoni

PRISHTINË, 20 DHJETOR (ER) - Dy projektet filmike fituese të konkursit të sivjetshëm të QKK-së për film të gjatë artistik, "I love you more", me skenar dhe

regji nga Erblin Nushi, dhe "Lëkura e krokodilit", me skenar dhe regji nga Ilirjan Himaj, janë mbështetur edhe nga Qendra Kinematografike Kombëtare e

Shqipërisë në kuadër të kategorisë së bashkëprodhimit minor. Ndërsa projekti për filmin e gjatë artistik kosovar "Era", me skenar dhe regji nga

Parta Kelmendi, është mbështetur nga Agjencia e Filmit të Maqedonisë Veriore, po ashtu në kuadër të kategorisë së bashkëprodhimit minor.









## Ndahen Channig Tatum dhe Jessie J



Aktori i njohur dhe këngëtarja Jessie J janë ndarë pas një viti lidhje të dashurisë. Një burim i afërt ka pohuar për "US Weekly" se ata janë ndarë, por se akoma janë

miq të mirë. Ish-çifti për herë të parë u panë bashkë në tetorin e vitit të kaluar. Tatum e konfirmoi lidhjen në nëntor kur postoi një fotografi të yllit pop në skenë në Royal Albert Hall.

## Mariah Carey ndez dritat e 'Empire State Building' dhe tregon format bombastike



Mbretëresha e muzikës për një natë në Empire State Building është Mariah Carey. Për ta festuar 25-vjetorin e këngës së saj 'All I want for Christmas is you', Carey e cila ka ndezur edhe dritat e ndërtesës së famshme të Big Apple, është shfaqur më në formë se

kurrë. 'All I want for Christmas is You' e Mariah Carey sapo ka arritur numrin 1 të Billboard Hot 100 dhe ylli i popit ka dashur të festojë me shumë stil duke treguar si gjithmonë format e saj bombastike me një fustan të gjatë me shkëlqim, që i ka nxjerrë në pah format seksi.



## "2 milionë në pesë ditë", Dafina Zeqiri bën namin me lëvizjet e nxehta

Këngëtarja e dashur për publikun shqiptar, Dafina Zeqiri, ka publikuar pesë ditë më parë këngën e saj më të re me titull, "Vuj vuj vuj". Projekti i saj është pritur mjaft mirë nga fansat, të cilët i shkruajnë se "nuk do të kishte kuptim dimri pa një këngë

të tillë". Ndërkohë në kanalin e "Youtube", "Vuj vuj vuj" ka marrë më shumë se dy milionë klikime. Për të festuar për këtë arritje, Dafina ka postuar në "Instagram" disa fotografi të shkëputura nga klipi, ku ajo shfaqet mjaft seksi dhe provokuese.

## Serena Williamsi merr mësimë boksi nga Mike Tyson




Tenistja e famshme, Serena Williams, ka filluar të merret edhe me boks. Boksieri i njohur, Mike Tyson, ka publikuar një video në

rrjetin social "Instagram", ku shihet ai duke e mësuar Serena Williams rreth boksit. "Ajo ka shumë forcë", ka shkruar Tysoni në këtë video.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Vedat Muriqi, futbollisti i vitit në Kosovë

Reprezentuesi i Kosovës dhe anëtari i Fenerbahçës, Vedat Muriqi, është shpallur futbollisti i vitit në Kosovë. "Po ndihem mirë që puna e një viti po shpërblehet. Për këtë çmim dua t'i falënderoj gjithë bashkëlojtarët e mi. Ka qenë një vit i mirë, i suksesshëm. Për mua është një motiv shtesë ky çmim. Në të ardhmen do ta jap maksimumin që ta ndihmoj ekipin dhe Kosovën. Kemi ëndërr që të kualifikohemi në Euro 2020 dhe besoj se me punë dhe këtë staf ëndërrën do ta bëjmë realitet", ka thënë Muriqi



**EPOKA E RE**

**Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 20 DHJETOR** - Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, është shpallur futbollisti i vitit 2019 në ceremoninë e organizuar të premtën nga Federata e Futbollit për shpalljen e "Laureatëve 2019". Muriqi gjatë vitit 2019 ka shkëlqyer në fanellën e "Dardanëve" si dhe me fanellën e skuadrës së Rizesportit e më pas edhe me atë të Fenerbahçës. "Po ndihem mirë që puna e një viti po shpërblehet. Për këtë çmim dua t'i falënderoj gjithë bashkëlojtarët. Ka qenë një vit i mirë, i suksesshëm. Për mua është një motiv shtesë ky çmim. Në të ardhmen do ta jap maksimumin që ta ndihmoj ekipin dhe Kosovën. Kemi ëndërr që të kualifikohemi në Euro 2020 dhe besoj se me punë dhe këtë staf ëndërrën do ta bëjmë realitet. Kërkoj falje që nuk isha aty për ta pranuar këtë çmim. Do të shihemi së shpejti për ta bërë ëndërrën realitet", ka thënë Muriqi, i cili ka munguar në ceremoni.

Në garë për këtë çmim ishin edhe Milot Rashica (Werder Bremen) dhe Amir Rrahmani (Hellas Verona). Vitin e kaluar këtë çmim e kishte fituar Arbër Zeneli. Në futbollin e Kosovës dominues ishte sul-

muesi Kastriot Rexha, pasi është shpallur golashënuesi dhe futbollisti i vitit në Superligë.

Sulmuesi prishtinas është ndër më meritoret për sukseset e skuadrës së Feronikelit në edicionin 2018/2019. Ndërsa skuadra e Feronikelit është shpallur më e mira e vitit, pasi i ka fituar titullin dhe Kupën e Kosovës. Nga kjo skuadër është shpallur edhe trajneri i vitit, Zekrija Ramadani, që u largua në fillim të këtij edicioni, derisa pesë futbollistë të "Niklit" ishin pjesë e formacionit të vitit 2019. Ndërkohë epiteti i gjyqtarit më të mirë i takoi Genc Nuzës. Skuadra më "fair-play" këtë vit u shpall Drenica nga Skenderaj. Te femrat klubi më i mirë u shpall Klubi KF Mitrovica, ndërsa futbollistja më e mirë u shpall Kaltrina Biqkaj. Në futsall, Liburni nga Gjakova u shpall klubi më i mirë, ndërsa lojtari më i mirë në futsall u shpall Alfred Prenci. Golashënuesi më i mirë për vitin 2019 ishte Ramadan Alaj. "Në vitin 2019 kemi pasur shumë më pak fjalë, kemi pasur më shumë punë, të cilat do të transmetohen. Të gjithë 'Dardanëve' u uroj një vit të mbarë! Pritshmëritë për 2020-n? Jemi të fokusuar në ndeshjet për kualifikime për 'Euro 2020'. Besojmë në ekipin, në gjithë stafin dhe shpresojmë të kualifikohemi në Evropian", ka thënë

Agim Ademi, kryetar i Federatës së Futbollit të Kosovës.

**Presidenti i UEFA-s: Kualifikimi në 'Euro 2020', dhurata më e mirë për ta nderuar figurën e Fadil Vokrrit**

Presidenti i UEFA-s, Aleksander Ceferin, ka dërguar një mesazh emocionues në ceremoninë e laureatëve për vitin 2019. Sipas tij, kualifikimi i Kosovës në Kampionatin Evropian do të ishte dhurata më e mirë për ta nderuar figurën e Fadil Vokrrit. "Të dashur miq, i dashur Agim Ademi, fillimisht urime për rezultatet fantastike prej kur vendi juaj është bërë anëtar zyrtar i UEFA-s. Vërtetuar se jeni vend i vërtetë i futbollit dhe duhet të jeni krenarë me atë që keni arritur deri tani. Jeni duke shkruar historinë. Ju e dini se mund të llogaritni gjithmonë në mbështetjen e UEFA-s për t'ju ndihmuar në rritjen dhe zhvillimin e futbollit. Sot ju jeni një nga anëtarët e 55-të të asociacionit tonë dhe shumë të respektuar. Po ashtu, urime lojtarëve që do të pranojnë sonte çmime. Ju nuk jeni vetëm futbollistë, jeni model për gjeneratat e ardhshme. Ju përfaqësoni shpresë për rininë... duke përkujtuar ish-kryetarin tuaj dhe shokun tonë të dashur, Fadil Vokrrin. Na mungon. Kualifikimi në 'Euro 2020', në muajin mars, do të ishte dhurata më e mirë për ta nderuar figurën e Fadil Vokrrit. Paçi fat! Shijojeni ceremoninë. Jetoftë gjatë futbollit kosovar!", thuhet në letrën e Ceferinit.

## SHKURT

### Kuka: Statuja e Majlindës po vjen në Kosovë

Trajneri i njohur i xhudos, Driton Kuka, përmes një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se statuja e kampiones së parë dhe të vetme olimpike, Majlinda Kelmendit, po vjen në Kosovë. "Po e ndaj me ju një informacion. Statuja e Majlindës po vjen në Kosovë. Kërkesa jonë nëpërmes Ministrisë drejtuar Komunitetit të Prishtinës qysh në muajt e verës deri sot ka mbetur pa përgjigje. E kemi menduar statujën të ngritët në kryeqytet si kampionia e parë dhe e vetme olimpike por, kot!!! Kryetari i Prishtinës asnjë informacion për këtë çështje... Jeta Xharra ishte sugjerimi yt që e kishim konsideruar për vendin e statujës e tash çka ma tutje kur kjo ka hasur në vesh të shurdhër!", ka shkruar Kuka.

### Klubi nga Bundesliga synon Xhakën

Mesfushori shqiptar i Arsenalit, Granit Xhaka, është synim i klubit gjerman Hertha Berlin. Lajmi është bërë me dije nga "Sky Germany". Trajneri i Herthas, Jurgen Klinsmann, po e dëshiron shqiptarin, i cili i ka prishur raportet me tifozët e Arsenalit dhe si pasojë i është hequr edhe shiriti i kapitenit. Ndërsa mediet angleze disa herë kanë raportuar se Xhaka do të largohet nga Arsenalin në janar.

### Rrahmani bën hapin e madh në karrierë, transferohet te Napoli

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Amir Rrahmani, karrierën futbollistike do ta vazhdojë në Serinë A, por ai do të largohet nga Verona për t'iu bashkuar Napolit. Lajmi është konfirmuar nga "La Gazzetta dello Sport". "Jo vetëm Sofian Amrabat, Napoli po mbyll gjithçka me Veronën edhe për blerjen e mbrojtësit Amir Rrahmani. Mbeten detajet e fundit për t'u përcaktuar për qendërmbrojtësin, por marrëveshja është arritur", shkruan "La Gazzetta dello Sport". Tutje e përditshmja italiane ka shkruar edhe për çmimin që pritet ta paguajë Napoli për Rrahmanin. "Rrahmani vlerësohet rreth 15 milionë euro dhe duket se Napoli do ta paguajë këtë shumë", ka shkruar GDS. 25-vjeçari këtë edicion ka zhvilluar 16 ndeshje këtë edicion me Veronën në Serinë A, ku në shumicën prej tyre ka qenë ndër më të dalluarit.

## FORMACIONI I VITIT NË KOSOVË

Portier: Visar Bekaj  
Mbrojtës: Armend Thaqi, Përparim Islami, Visar Berisha, Arbër Prekazi  
Mesfushorë: Arb Manaj, Albert Dabiqaj, Mendurim Hoti  
Sulmues: Kastriot Rexha, Blendi Baftiu dhe Xhevdet Shabani











Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"  
Fakulteti Ekonomik, Prishtinë

#### NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 27.12.2019, në ora 12:00, në Fakultetin Ekonomik (Salla e Profesorëve), kandidatja MSc. Leonora Haliti Rudhani, i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës me titull "Menaxhimi i riskut të likuiditetit në funksion të ngritjes së performancës financiare të bankave komerciale në Kosovë" me mentor Prof. Asoc. Dr. Driton Balaj, para komisionit profesional në këtë përbërje:

Prof. Dr. Skender Ahmeti – kryetar  
Prof. Asoc. Dr. Rustem Asllanaj – anëtar  
Prof. Dr. Seadin Xhaferi – anëtar i jashtëm.



Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"  
Fakulteti Ekonomik, Prishtinë

#### NJOFTIM

Njoftohen të gjithë të interesuarit se me datë 30.12.2019 (të hënën) prej orës 13:00, në Fakultetin Ekonomik (salla e profesorëve), kandidatja MSc. Arbana Sahiti i nënshtrohet mbrojtjes publike të Punimit të Doktoratës me temën: "Menaxhimi i riskut kreditor nga bankat tregtare të Kosovës për periudhën 2008 – 2016", me mentor Prof. Dr. Skender Ahmeti, para komisionit profesional, në përbërje prej:

Prof. Asoc. Dr. Driton Balaj - kryetar i komisionit,  
Prof. Dr. Muhamet Aliu - anëtar i komisionit,  
Prof. Asoc. Dr. Etem Iseni - anëtar i jashtëm i komisionit (Universiteti i Tetovës).

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Ar Beton" sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

#### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Lubozhdë komuna e Istogut.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.01.2020 në ora 13:30 në hapësirat e restorant "Felix Events" afër stadiumit të qytetit në Istog do të organizohet debat publik nga kompania "Ar Beton" sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit në Lubozhdë komuna e Istogut.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

#### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Magbule Alshiqi shpall të pavlefshme INDEX-in, e fakultetit Juridik të UP-së, Prishtinë.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtime i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

#### Shpallje për gazetë

#### Ofertë për shitjen e patundshmërisë

1. Erhan Mulla, me adrese ne rr."Remzi Ademaj" nr.34 KK Prizren, i pajisur me letërnjoftim – numër personal 1173606938 të lëshuar nga MPB e Kosovës – Prishtinë,

2. Edisa Mulla, me adrese ne rr."Remzi Ademaj" nr.34 KK Prizren, i pajisur me letërnjoftim – numër personal 1007151744 të lëshuar nga MPB e Kosovës – Prishtinë, dhe

janë bashkëpronar me pjesën prej 3/2072 e pjesës ideale (15 m2) të patundshmërisë, me numër të Njësisë kadastrale P-71813068-06712-0, në vendin e quajtur "Pashaallti", me kulturë bujqësore arë e kl.3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5188 m2, Zona kadastrale Prizren,

Nga pjesa e vet ideale oferton për shitje sipërfaqen e përgjithshme prej 15 m2 (3/2072 e pj. ideale) të patundshmërisë me të dhënat si më lart, në shumën e përgjithshme prej 2.800 € (me shkronja: Dy mijë e teteqind euro).

Prizren, 20.12.2019

Ofertuesit,  
1.Erhan Mulla  
2.Edisa Mulla

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistranja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.